



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Në bazë të nenit 12.2 dhe 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës 03/L-040, Kuvendit Komunal të Rahovecit, në mbledhjen e vet të mbajtur më **16 dhjetor 2010**, merr këtë

S T A T U T TË KOMUNËS SË RAHOVECIT

PJESA E PARË KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Statuti i Komunës, është akti më i lartë juridik i Komunës që miratohet nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me nenin 12 pika 3 e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Statuti rregullon organizimin e brendshëm të komunës. Në përdorimin e mëtutjeshëm do të njihet si “Statuti i Komunës” i cili aprovohet me 2/3 të këshilltarëve të zgjedhur të KK-së.

Neni 2

Përgjegjësitë e Komunës ushtrohen, organizohen dhe menaxhohen në pajtueshmëri të plotë me ligjet të cilat rregullojnë kompetencat e Komunës në harmoni me Statutin dhe Rregulloren e punës të miratuar nga Kuvendi i Komunës.

Neni 3

3.1 Statuti i komunës zbatohet brenda kufijve të Komunës së Rahovecit.

3.2 Komuna mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuese me komunat tjera në pajtueshmëri me ligjin në fuqi.

Neni 4

Organet e komunës janë:

- i. Kuvendi i Komunës është organi më i lartë vendimmarrës i Komunës;
- ii. Kryetari i Komunës është organi më i lartë ekzekutiv i Komunës.

Neni 5

Brenda territorit të saj Komuna ushtron përgjegjësitë të cilat nuk i janë rezervuar shprehimisht me ligj, institucioneve qendrore.

SIMBOLET

Neni 6

6.1 Komuna ka emblemën dhe flamurin e vetë. Përmbajtja dhe përdorimi i emblemës dhe flamurit do të përcaktohen me vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës, i nxjerrë në pajtim me aktet ligjore në fuqi të cilat rregullojnë këtë lëmi.

6.2 Asnjë subjekt dhe person tjetër përveç komunës nuk mund të përdorë emblemën, flamurin, shenjat komunale dhe simbolet e saj, pa autorizim paraprak të dhënë nga organet kompetente komunale.

Neni 7

Komuna i ka vulat e veta. Mënyra e mbajtjes dhe përdorimi i vulave do të përcaktohet me vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës i nxjerrë në pajtim me aktet ligjore në fuqi të cilat rregullojnë këtë fushë.

Neni 8

Selia e Komunës është në qytetin Rahovec, në rrugën “Xhelal Hajda – Toni”, p.n.

Neni 9

Komuna ka ditët e festave publike: Ditën e çlirimit më 14 qershor të çdo viti, Ditën e dëshmorëve më 12 maj dhe 7 shtator Ditën e vjeljes së rrushit.

Neni 10

10.1 Kuvendi i Komunës jep shpërblime, dekorata dhe mirënjohje.

10.2 Kuvendi i Komunës, me vendim të veçantë, përcakton kushtet dhe mënyrën e dhënies së shpërblimeve, dekoratave dhe mirënjohjeve.

10.3 Dhënia e mirënjohjeve, shpërblimeve në të holla ose shpërblimeve të tjera nuk duhet të tejkalojnë shumën prej 100 €, përveç në raste të veçanta kur Kuvendi i Komunës merr vendim për një shumë më të lartë.

PJESA E DYTË

KAPITULLI I – PROCEDURAT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIM TË STATUTIT TË KOMUNËS

Neni 11

11.1 Iniciativa për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës mund të ndërmerret nga:

- a) Kryetari i Komunës
- b) Një e treta (1/3) e anëtarëve të Kuvendit të Komunës
- c) Me iniciativën e 15% të qytetarëve me të drejtë vote në komunë.

11.2 Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit komunal duhet të dërgohet tek Kuvendi i Komunës për shqyrtim fillestar. Kuvendi i Komunës para shqyrtimit final duhet të konsultoj publikun në lidhje me atë propozim.

11.3 Pas përfundimit të periudhës së konsultimit, Kuvendi Komunal duhet të vendos se a do ta miratoj statutin me ndryshime dhe plotësime, pas shqyrtimit të të gjitha vërejtjeve të marra.

11.4 Çdo propozim për ndryshim apo plotësim të Statutit të Komunës miratohet në Kuvendin e Komunës, ashtu siç përcaktohet në nenin 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

PJESA E TRETË

KAPITULLI I – FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE

Neni 12

Territori i komunës është përcaktuar në Ligjin për kufijtë administrativ të komunave. Komuna e Rahovecit përbëhet prej qytetit të Rahovecit, 34 fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Neni 13

13.1 Për të siguruar plotësimin e të gjitha nevojave të qytetarëve dhe ushtrimin e përgjegjësive nga autoritetet lokale për të qenë sa më afër qytetarëve, Komuna përmes Kuvendit të Komunës apo Kryetarit të Komunës vendosë të bëjë aranzhime me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane brenda territorit të saj.

13.2 Kuvendi i Komunës përcakton aktivitetet që mund ti ushtrojnë fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, e që janë në kuadër të përgjegjësive dhe kompetencave të komunës.

13.3 Kuvendi i Komunës për këto njësi siguron ndarjen e resurseve nga komuna, që janë në përpjesëtim me përgjegjësitë dhe aktivitetet e përcaktuara.

Neni 14

14.1 Për shtrirjen edhe më tej të përgjegjësive të përcaktuara me ligj, komuna mund të krijojë zyre komunale informuese dhe shërbyese për të ofruar shërbime më pranë qytetarëve të saj.

14.2 Komuna mban kontrollin e plotë të secilës fushë të kompetencës së saj të de-koncentruar.

14.3 Zyrrat komunale që do të funksionojnë në kuadër të komunës do të përcaktohen me vendim të posaçëm të Kuvendit të komunës.

Neni 15

Zyra komunale duhet të përbëhet nga pjesa administrative dhe duhet të drejtohet nga personeli i cili emërohet nga komuna. Për ushtrimin e detyrave të saja, zyrës i përcaktohen fondet e nevojshme nga Komuna.

PJESA E KATËRT

KONSULTIMET DHE PJESMARRJA E PUBLIKUT

KAPITULLI I – KONSULTIMET ME PUBLIKUN

Neni 16

16.1 Komuna duhet të konsultoj publikun në mënyrë që të sigurojë se vendimet e marra janë të bazuara fuqishëm në fakte, janë marrë parasysh pikëpamjet dhe përvojat e qytetarëve si dhe që janë përdorur mundësitë e reja dhe kreative para marrjes së vendimit, dhe që të gjitha vendimet e propozuara mund të zbatohen në mënyrë efektive në praktikë.

16.2 Komuna gjithashtu duhet të siguroj që qytetarët të kenë mundësi ta shprehin mendimin e tyre dhe se interesat dhe kërkesat e tyre të merren parasysh.

Neni 17

Komuna mund të shfrytëzoj format e konsultimeve të shënuara më poshtë dhe format tjera të konsultimeve sipas nevojës dhe rrethanave:

1. Fushatat informative dhe të publicitetit për të promovuar aktivitetet dhe programet komunale;
2. Kontaktet me grupet e fokusit, për t,i testuar dhe diskutuar politikat;
3. Anketat për implementimin e politikës, përfshirë përveç të tjerave: informues kyç, klientë dhe qytetarë të prekur nga kjo;
4. Shpalljet publike të propozimeve për politika apo draft rregulloret, duke i thirrur për pjesëmarrje në prezantime;
5. Kontaktet me grupet e interesit dhe mbledhjet me grupet e interesit;
6. Takimet publike;
7. Dëgjimet publike;
8. Studimet për vlerësim të efektit.

Neni 18

Në secilin rast duhet të jepet një arsyetim për mbajtjen e konsultave me publikun.

Mënyra e cila shfrytëzohet për mbajtjen e konsultave me publikun duhet të publikohet 14 ditë përpara dhe duhet të lejohet kohë e duhur për përgatitjen e prezantimeve. Rezultatet e konsultimeve duhet të merren parasysh dhe duhet të bëhen publike para se të merret vendimi.

Neni 19

19.1 Të gjitha komunikimet në lidhje me konsultimet duhet të jenë të qarta, dhe duhet të përfshijnë të gjitha informatat e nevojshme për t,i lehtësuar përgjigjet. Një dokument konsultues duhet të përfshijë një përmbledhje, prej dy faqesh më së shumti, të çështjeve dhe të pyetjeve kryesore për të cilat janë kërkuar mendimet e tyre.

19.2 Kur përcaktohen grupet e fokusit në procesin e konsultimit, komuna duhet të siguroj që palët relevante kanë mundësi t,i shprehin mendimet e tyre.

Neni 20

Komuna duhet të sigurojë publicitetin e duhur dhe duhet t,i adaptoj kanalet komunikuese në mënyrë që të përmbushë synimet e audiencës. Pa përjashtuar mjetet tjera të komunikimit, konsultat e hapura për publikun duhet të publikohen në faqen zyrtare të komunës.

Neni 21

Komuna duhet të lejoj kohë të mjaftueshme për shqyrtimin e përgjigjeve dhe kontributeve me shkrim. Komuna duhet t,i lejojë së paku 8 javë për marrjen e përgjigjeve me shkrim për konsultimin e publikut, ndërsa standardi duhet të jetë 12 javë.

Neni 22

Përgjigjet duhet të analizohen dhe rezultatet duhet të bëhen publike, duke iu kushtuar rëndësi mendimeve të shprehura në marrjen përfundimtare të vendimit. Rezultatet e konsultave të hapura me publikun duhet të vendosen në faqen zyrtare të komunës.

KAPITULLI II - TUBIMET ME PUBLIKUN

Neni 23

23.1 Takimet me publikun duhet të mbahen në një sallë që është e mjaftueshme për pjesëmarrjen e publikut të interesuar. Komuna duhet të mbajë së paku dy takime me publikun çdo vit, një në gjashtë mujorin e parë dhe një tjetër në gjashtëmujorin e dytë.

23.2 Përveç kësaj, takimet tjera me publikun mund të mbahen, duke marrë parasysh se duhet të ekzistoj një interval prej dy muaj ndërmjet dy takimeve.

Neni 24

24.1 Vendi, data dhe koha e mbajtjes së takimit publik duhet të shpallen së paku 14 ditë para mbajtjes së takimit. Takimet publike duhet të mos mbahen në datat apo kohën që në përgjithësi nuk është e përshtatshme për pjesëmarrjen e komuniteteve të veçanta.

24.2 Përfaqësuesit e mediave mund të marrin pjesë në të gjitha takimet me publikun.

Neni 25

25.1 Kryetari i Komunës apo përfaqësuesit e tij/saj, duhet ta kryesojnë mbledhjen me publikun. Ai/ajo duhet të ketë autoritetin ta përcaktojë procedurën e cila do të shfrytëzohet gjatë mbledhjes si dhe ka autoritetin të mos lejoj diskutimin për disa çështje të caktuara që nuk janë të lidhura me çështjet e diskutuara të cilat nuk janë në kuadër të pushtetit të komunës ose nuk kanë të bëjnë me punët e komunës.

25.2 Ai/ajo mund të vendosë të mos i dëgjojë folësit të cilët prezantojnë pikëpamje të njëjta apo i përsërisin ato dhe mund të përcaktojë një limit kohor për kohën të cilën e kanë në dispozicion folësit.

Neni 26

26.1 Nëse bëhet një pyetje në takim publik, që nuk mund të ketë përgjigje gjatë takimit, pyetësi mund të kërkojë përgjigje me shkrim në një periudhë prej 30 ditësh, pas ditës së takimit.

26.2 Peticioni i paraparë në nenin 69 të LVL, kryesuesit të Kuvendit i dorëzohet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit, i cili në Kuvend duhet të shqyrtohet në afat prej 30 ditë.

Neni 27

Procesverbali i secilit takim publik duhet të ruhet me të gjitha informatat të hollësishme që jepen për komunën, si dhe të gjitha propozimet e bëra nga anëtarët e publikut dhe përgjigjet që janë dhënë në pyetjet e bëra. Një kopje e të gjitha përgjigjeve të dhëna me shkrim, në ndonjë datë të mëvonshme duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit të takimit.

Neni 28

Komiteti për politikë dhe financa duhet ta shqyrtoj procesverbalin e mbledhjes publike brenda 60 ditëve pas mbledhjes. Komiteti duhet ta shqyrtoj secilin propozim të dhënë gjatë mbledhjes dhe pas kryerjes së konsultimeve të nevojshme të bëjë rekomandimet e duhura në takimin e ardhshëm të Kuvendit Komunal.

KAPITULLI III - KOMITETET KËSHILLDHËNËSE

Neni 29

Kuvendi komunal duhet të formoj komitetet këshillëdhënëse sektoriale që do të mundësonin pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendim-marrjes. Në emërimin e anëtarëve të këtyre komiteteve, Kuvendi Komunal duhet të siguroj një përfaqësim të gjerë nga sektorë të ndryshëm të shoqërisë; në krijimin e këtyre komiteteve duhet të merret parasysh balancë gjinore dhe ato duhet të reflektojnë interesat e komuniteteve ekzistuese dhe fshatrave brenda komunës.

Neni 30

30.1 Komitetet këshillëdhënëse duhet të paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve tek Kuvendi i Komunës.

30.2 Komitetet këshillëdhënëse gjithashtu mund të bëjnë propozime për përmirësimin apo zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

30.3 Në kryerjen e detyrave të tyre, Komitetet këshillëdhënëse duhet të punojnë së bashku me Komitetet e Kuvendit në mënyrë që vendimet e komiteteve të Kuvendit apo të Kuvendit të komunës të merren vetëm pas konsultimit me komitetin këshillëdhënës sektorial.

Neni 31

Anëtarët e komiteteve këshillëdhënëse duhet të emërohen me mandat 3 vjeçar në baza të rregullta, ku 1/3 e anëtarëve duhet të emërohet çdo vit. Asnjë anëtar i Komitetit këshillëdhënës nuk mund të shërbej më shumë se në dy mandate të njëpasnjëshme.

Neni 32

Me vendim të posaçëm Kuvendi i komunës formon komitetet tjera të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësive të tyre të cilat reflektojnë përbërjen e Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

PJESA E PESTË

KUVENDI I KOMUNËS DHE KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

KAPITULLI I - KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 33

Kuvendi i Komunës zgjedhë kryesuesin e Kuvendit të Komunës, me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konform nenit 41 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Neni 34

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës i thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

Neni 35

Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës mund të thirren me kërkesën me shkrim e 1/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe nga kryetari i Komunës, në bazë të rregullave dhe procedurave ligjore.

KAPITULLI II – KOMITETET E PËRHERSHME

Neni 36

36.1 Pas konstituimit, Kuvendi i Komunës formon komitetet e përhershme në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale:

- a) Komitetin për Politikë dhe financa
- b) Komitetin për Komunitete.

36.2 Numri i anëtarëve të Kuvendit në secilin komitet duhet të përcaktohet nga Kuvendi i Komunës.

36.3 Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës anëtarët e komiteteve, që nuk janë anëtar të Kuvendit të Komunës.

Neni 37

Komitetet tjera komunale

1. Komiteti për urbanizëm, kadastër, gjeodezi dhe shërbime publike lokale,
2. Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport,
3. Komiteti për shëndetësi, mirëqenie sociale dhe barazi gjinore,
4. Komiteti për zhvillim ekonomik, bujqësi dhe mbrojtje të ambientit,
5. Komiteti për siguri në bashkësi,
6. Grupi punues për kthimin e të zhvendosurve.

KAPITULLI III – MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS DHE KOMITETEVE

Neni 38

Në takimet e tyre të para në secilin vit fiskal Kuvendi i Komunës dhe secili komitet duhet t'i caktoj datat fikse në të cilat duhet të mbahen takimet e rregullta gjatë vitit. Data e

mbajtjes së takimeve mund të ndryshon me vendime pasuese. Takimet tjera mund të thirren në çdo kohë.

Neni 39

Të gjitha takimet duhet të thirren dhe mbahen në pajtueshmëri me Rregulloren e punës. Personi i cili thërret apo udhëheqë takimet duhet të sigurojë që të gjithë anëtarët që marrin pjesë në mbledhje kanë të drejta të njëjta dhe të barabarta, dhe të kenë mundësi të marrin pjesë në të gjitha veprimet.

Neni 40

40.1 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të Kuvendit të Komunës janë të hapura për publikun, mjetet e informimit dhe subjekteve interesi i të cilave është objekt diskutimi përveç në rastet që parashihen ndryshe me legjislacionin në fuqi.

40.2 Kuvendi i Komunës nëpërmjet Zyrës Përgjegjëse për informim njofton Publikun të paktën 7 ditë para mbledhjeve të rregullta ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme ndër të tjera me mjetet e mëposhtme:

- i. Shpallja publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës;
- ii. Mediat e shkruara dhe elektronike lokale dhe
- iii. Faqen e internetit të Kuvendit të Komunës.

40.3 Njoftimet publike duhet të përmbajnë:

- a) Datën e mbledhjes
- b) Kohën e mbledhjes
- c) Vendin e mbajtjes së mbledhjes
- d) Rendin e ditës.

40.4 Komitetet nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim njoftojnë publikun 3 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve. Njoftimet publike përmbajnë:

- a) Datën e mbledhjes
- b) Kohën e mbledhjes
- c) Vendin e mbajtjes së mbledhjes
- d) Rendin e ditës.

Neni 41

Çdo anëtar i publikut i cili merr pjesë në Kuvendin e Komunës dhe komiteteve të tij, me lejen e kryesuesit të takimit, mund të bëjë pyetje dhe mund të drejtohet mbledhjes. Rregullorja e punës mund të rregulloj të drejtat dhe veprimet e udhëheqësit të mbledhjes gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

Neni 42

42.1 Të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të emërohen nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Anëtarësimi në çdo rast duhet të pasqyrojë në mënyrë sa më të përafërt proporcionin e nivelit të përfaqësimit të partive politike dhe përfaqësimit gjinorë në Kuvendin Komunal.

42.2 Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteteve tjera.

42.3 Numri i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të jetë 9 anëtarë.

42.4 Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa kryesohen nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës. Në mungesë të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës mbledhjet kryesohen nga njëri prej anëtarëve të këtij Komiteti.

Neni 43

43.1 Anëtarët e Komitetit për Komunitete emërohen nga Kuvendi i Komunës nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesve të komuniteteve pakicë.

43.2 Numri i anëtarëve të Komitetit për Komunitete duhet të jetë prej 7 anëtarëve.

43.3 Komiteti për Komunitete në Komunë përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve pakicë që jetojnë në komunë. Shumica e anëtarëve të këtij Komiteti përbëhet nga komuniteti pakicë.

KAPITULLI IV - INFORMIMI PËR ANËTARËT E KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 44

44.1 Kërkesat për informata që kanë të bëjnë me çështjet komunale, të cilat bëhen nga anëtarët e Kuvendit të Komunës të përcaktuara në nenin 39 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, duhet të adresohen me shkrim tek zyrtari përgjegjës i Komunës nga i cili kërkohen informatat.

44.2 Zyrtari përgjegjës i Komunës në afat prej 15 ditëve duhet ti përgjigjet me shkrim anëtarit ose anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

44.3 Një kopje e kërkesës dhe e përgjigjes duhet të futet në regjistër nga zyrtari përgjegjës komunal, i cili duhet ta shënoj datën e kërkesës së marrë dhe datën e përgjigjes së dhënë.

44.4 Në qoftë se zyrtari komunal konsideron se dhënia e ndonjë përgjigje për kërkesën apo pyetjen e veçantë është e dëmshme për interesat e përbashkëta të qytetarëve të

komunës, ai mund të refuzojë me shkrim duke paraqitur arsyet për dhënien e përgjigjes së tillë.

KAPITULLI V – KOMPENSIMI I ANËTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 45

Kompensimi për anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe anëtarëve të komiteteve për punën që ata e bëjnë për Komunën duhet të mos tejkalojë rregullat e përcaktuara nga Qeveria Qendrore e Republikës së Kosovës.

Neni 46

Kuvendi i Komunës nxjerr vendim në pajtim me Ligjin për mënyrën dhe lartësinë e kompensimit të punës për anëtarët e Kuvendit, Kryesuesin e Kuvendit si dhe për anëtarët e Komiteteve të KK-së.

KAPITULLI VI – KONFLIKTI I INTERESIT I ANËTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 47

Anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk mund të jenë edhe anëtarë të emëruar në Ekzekutivin dhe Administratën e Komunës.

Neni 48

Përjashtimet në procesin e vendimmarrjes për shkak të konflikteve të interesit bëhen në bazë të nenit 37 dhe 38 t Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe duhet të shënohen në procesverbalin e mbledhjes të Kuvendit të Komunës.

Neni 49

Anëtarët që kanë konflikt të interesit në lidhje me një çështje të caktuar nuk duhet të flasin e as të votojnë për çështjen për të cilën kanë konflikt të interesit dhe duhet të dalin nga salla e mbledhjes atëherë kur diskutohet ajo çështje.

Neni 50

50.1 Nëse vije deri te ndonjë konflikt potencial i interesit pasi që është marrë vendimi, por para se të zbatohet ai, vendimi duhet të suspendohet dhe çështja duhet të hetohet.

50.2 Nëse arrihet në përfundimin se ka ekzistuar konflikti i interesit, vendimi duhet të anulohet tërësisht dhe duhet të bëhet një votim i ri për marrjen e vendimit.

KAPITULLI VII – MARRËDHËNIET NDËRKOMUNALE DHE PARTNERITETET

Neni 51

51.1 Kryetari i Komunës pas konsultimeve me Komitetin për politikë dhe financa duhet të prezantoj rekomandimet për Kuvendin e Komunës për marrëveshje të cilat mund të jenë të nevojshme në bazë të nenit 28 dhe 29 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

51.2 Kuvendi i Komunës vendos për lidhjen e marrëveshjeve ndërmjet komunave për ushtrimin e përgjegjësisë dhe pushtetit në bashkëpunim me njëra tjetrën.

Neni 52

Kryetari i Komunës pas konsultimit me Komitetin për Politikë duhet t'i prezantoj rekomandimet e tij tek Kuvendi i Komunës në lidhje me marrëveshjet të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e ndërmarrjeve komunale për mbikëqyrjen e shërbimeve të përbashkëta publike lokale që ofrohen në më shumë se një komunë.

Neni 53

Kuvendi komunal mund, që brenda kornizës së Ligjit, të bëjë marrëveshje që të bashkëpunoj dhe të formoj partneritete me kuvendet tjera komunale ashtu që të kryejnë detyrat që janë në interes të përbashkët.

Neni 54

Kuvendi komunal mund të bashkohet me kuvendet tjera komunale në asociacione për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të përbashkëta.

KAPITULLI VIII – FINANCAT KOMUNALE DHE PROCEDURAT BUXHETORE

Neni 55

55.1 Komuna ka buxhetin dhe financat e veta për të ushtruar kompetencat e saja. Buxheti dhe financa të komunës rregullohen me Ligjin për Financat Lokale dhe aktet tjera.

55.2 Të gjitha çështjet që janë të lidhura me administrimin financiar të Komunës janë përgjegjësi e Kryetarit të Komunës.

55.3 Kryetari i Komunës këto përgjegjësi që kanë të bëjnë me administrimin financiar mund t'i bartë tek nënkryetari i Komunës apo te ndonjë prej drejtorëve të drejtorive komunale.

PJESA E GJASHTË

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

KAPITULLI I – KRYETARI I KOMUNËS DHE ADMINISTRATA KOMUNALE

Neni 56

Kryetari i Komunës zgjidhet me mandat katër vjeçar, të njëjtë me anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Neni 57

Kryetari i Komunës është udhëheqës i degës ekzekutive të komunës dhe zgjedhet drejtpërdrejt nga qytetarët me të drejtë vote.

Neni 58

Kryetari i Komunës nxjerr aktet juridike të parapara sipas nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Neni 59

59.1 Kryetari i Komunës ushtron përgjegjësit e përcaktuara me nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

59.2 Përgjegjësitë tjera të Kryetarit të Komunës janë si në vijim:

- i. Mbikëqyrë administrimin e përgjithshëm financiar të Komunës;
- ii. Mbikëqyrë zbatimin e të gjitha akteve juridike të aprovuara nga Kuvendi i Komunës;
- iii. Deleton përgjegjësi të drejtorët komunal dhe mbikëqyrë zbatimin e përgjegjësive të deleguara;
- iv. I propozon Kuvendit të Komunës ndryshime në lidhje me funksionin dhe numrin e drejtorive dhe funksionet e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- v. I ofron propozime Kuvendit të Komunës për konstituimin, organizimin dhe koordinimin e organeve komunale si dhe krijimin e institucioneve dhe ndërmarrjeve;
- vi. Bënë caktimin apo ndarjen dhe koordinimin e përkohshëm të punëve dhe përgjegjësive në mes të drejtorive sipas nevojës, duke pasur për bazë lëmin apo projektin e caktuar;

Nënkryetari i Komunës

Neni 60

60.1. Nënkryetari emërohet nga kryetari për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga kryetari.

Neni 61

Me kërkesë të kryetarit, nënkryetari i ndihmon kryetarit në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të kryetarit në mungesë të tij.

PJESA E SHTATË

KAPITULLI I – ADMINISTRATA KOMUNALE

Organizimi i brendshëm

Neni 62

62.1 Administrata Komunale përbëhet nga Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoritë Komunale, Zyra e personelit, Auditori i brendshëm dhe Zyra e prokurimit.

62.2 Zyra e kryetarit të Komunës, Drejtoritë Komunale, Zyra e personelit, Auditori i brendshëm dhe Zyra e prokurimit ushtrojnë kompetencat nga fushëveprimi i Komunës të përcaktuara me dispozitat ligjore dhe me këtë statut.

62.3 Në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe të drejtorive mund të themelohen zyrat.

62.4 Zyrën e Kryetarit të Komunës e udhëheqë Kryetari në mënyrë të drejtpërdrejt, drejtoritë i udhëheqin drejtorët e emëruar nga kryetari i Komunës, sektorët i udhëheqin shefat e sektorëve, ndërsa Zyrën e personelit e udhëheq Udhëheqësi i personelit.

62.5 Drejtorët udhëheqin drejtorinë e tyre në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit në pajtim me Ligjin dhe rregulloret komunale në fuqi.

62.6 Drejtorët e drejtorive i raportojnë rregullisht Kryetarit për çështje që janë nën përgjegjësinë e tyre dhe i ofrojnë të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.

Zyra e Kryetarit të Komunës

Neni 63

63.1 Në zyrën e Kryetarit të Komunës organizohen zyrat konkrete që hyjnë në funksion të mbarëvajtjes së aktiviteteve të Kryetarit.

63.2 Zyra e kryetarit të Komunës përbëhet nga:

Zyrtari për protokoll,
 Zyrtari për përfaqësim,
 Zyrtari për çështje ligjore,
 Zyrtari për marrëdhënie me publikun,

63.3 Zyra e prokurimit dhe Auditori i brendshëm ushtrojnë kompetencat nga fushëveprimi i Komunës të përcaktuara me dispozitat ligjore, dhe janë nën kompetencë të kryetarit të Komunës.

Neni 64

Administrata Komunale organizohet në drejtori. Çdo drejtori komunale menaxhohet nga drejtori. Drejtorët emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Komunës.

Drejtoritë Komunale

Neni 65

Komuna me këtë Statut themelon drejtoritë komunale, me emërtime si vijon:

- 1. Drejtoria për Administratë të Përgjithshme**
- 2. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale**
- 3. Drejtoria për Arsim**
- 4. Drejtoria për Financa, Buxhet,**
- 5. Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim**
- 6. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit**
- 7. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë**
- 8. Drejtoria për Shërbime Publike Komunale dhe Emergjencë**
- 9. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural**
- 10. Drejtoria për Punët Inspektuese**
- 11. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport,**
- 12. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.**

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

Neni 66

66.1 Në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme themelohen sektorët dhe zyrat me emërtimet në vijim:

1. Sektori për Administratë të Përgjithshme,
2. Sektori për punë të Kuvendit dhe Komiteteve,
3. Sektori për Gjendjen Civile,

4. Sektori për Mirëmbajtje, Logjistikë dhe Sigurim të Objekteve,
5. Sektori për barazi gjinore, të drejtat e njeriut dhe integrim evropian dhe të drejtat e fëmijëve.

66.2 Drejtoria për Administratë kryen punët dhe ushtron këto përgjegjësi:

- a) Kryen punët teknike administrative dhe juridike për përgatitjen e mbledhjeve të Kuvendit të komunës dhe komiteteve të tij.
- b) Bënë pranimin dhe dërgimin e shkresave të organeve dhe kërkesave të palëve të cilat u drejtohen organeve të Administratës komunale duke përfshirë dhënien e ndihmës dhe udhëzimeve juridike.
- c) Kryen punët nga lëmi i gjendjes civile.
- d) Bënë ruajtjen dhe arkivimin e lëndëve të organeve të komunës.
- e) Kryen shërbime të përkthimit për Kuvendin e komunës, komitetet e tija dhe Administratën komunale.
- f) Kryen punët e mirëmbajtjes të objekteve dhe zyrave të punës, teknologjisë informative, ruajtjes së objekteve të Administratës komunale, shërbimeve të transportit për shërbime zyrtare.
- g) Kryen punët nga kompetenca e barazisë gjinore, drejtat e njeriut, integrimet evropiane, zyrës për kthim dhe të drejtat e fëmijëve.
- h) Kryen edhe punët tjera të parapara me ligj.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Neni 67

67.1 Në kuadër të kësaj Drejtorie themelohen sektorët me emërtimet në vijim

1. Sektori për shëndetësi
2. Sektori për Përkujdesje sociale

67.2 Drejtoria për shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ushtron përgjegjësitë që i ka komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i shëndetësisë primare dhe përkujdesjes sociale:

- a) Kryen punët dhe është përgjegjëse sigurimin e ofrimit të kujdesit parësor primar, shëndetësor si dhe përcjelljen e gjendjes shëndetësore të qytetarëve të Komunës.
- b) Kryen punët në zbatimin e kujdesit shëndetësor parësor duke i dhënë përparësi masave të realizoj politikat zhvillimore lidhur me planifikimin, organizimin dhe ndërmarrjen e masave parandaluese shëndetësore nëpërmjet të konceptit të mjekësisë familjare.
- c) Kujdeset që Komuna të realizoj politikat zhvillimore lidhur me planifikim, organizimin dhe financimin e kujdesit shëndetësor.
- d) Koordinon dhe mbikëqyrë punën e QKMF-së, QMF, ambulancave të mjekësisë familjare dhe veprimtarisë private shëndetësore.
- e) Siguron përkujdesje ndaj kategorive të dala nga lufta, familjeve të dëshmorëve, martirëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së.
- f) Përkujdeset për sigurimin e strehimit për të pastrehët.

- g) Bashkëpunohet me Qendrën për punë sociale në Komunë, rreth përkujdesjes të rasteve sociale të popullatës së Komunës,
- h) Vendos dhe mbledh bashkë pagesat brenda Kornizës së caktuar nga Ministra e Shëndetësisë.
- i) Mbikëqyrë situatën epidemiologjike në nivel komunal.
- j) Kryen edhe punët tjera nga lëmi i mbrojtjes shëndetësore dhe sociale në pajtim me dispozitat ligjore.

Drejtoria për arsim

Neni 68

68.1 Në kuadër të kësaj Drejtorie themelohen sektorët me emërtimet në vijim

1. Sektori për arsimin parafillor, fillor dhe i mesëm i ulët
2. Sektori për arsimin e mesëm të lartë

68.2 Drejtoria për arsim ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i arsimit:

- a) Planifikon zhvillimin e arsimit në Komunë dhe aftësimin e personelit mësimor në bashkëpunim të ngushtë me MASHT-in.
- b) Nxitë bashkëpunimin e personelit arsimor në raport me nxënësit dhe prindërit.
- c) Siguron mirëmbajtjen dhe riparimin e objekteve shkollore dhe objekteve të tjera përcjellëse.
- d) Merr pjesë në përzgjedhjen e drejtorit dhe kuadrit arsimor të shkollave.
- e) Menaxhon me objektet komunale arsimore.
- f) Bënë regjistrimin e të dhënave personale për nxënës sipas formularit të miratuar nga MASHT-i dhe në harmoni me ligjin.
- g) Në marrëveshje me MASHT-in miraton rregullat për themelimin, shkrirjen, ndarjen dhe mbylljen e institucioneve arsimore.
- h) Marrjen e masave për të siguruar që ambienti rrethues urban apo rural në të cilin është vendosur shkolla është me përputhje me të drejtën e nxënësve për të pasur një mjedis të sigurt në oborrin e shkollës.
- i) Miratimin e pushimeve lokale të shkollës në përputhje me ligjin përkatës dhe miratimin e rregullave të shkollës.
- j) Merr vendime për ankesa ndaj vendimeve drejtuese të institucioneve arsimore të parapara me Ligj.
- k) Shqyrton vazhdimisht masat e marra për realizimin e arsimit special.
- l) Kujdeset për arsimimin e të rriturve në bazë të Ligjit në fuqi.
- m) Kryen edhe punët tjera të parapara me Ligj dhe këtë Statut

Drejtoria për Financa dhe Buxhet

Neni 69

69.1 Në kuadër të kësaj Drejtorie themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

1. Sektori për buxhet dhe financa,
2. Sektori për tatim në pronë,

69.2 Drejtoria për buxhet dhe financa ushtron përgjegjësitë që ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i buxhetit, financave, ekonomisë dhe zhvillimit:

- a) Bënë përgatitjet e projektit të Buxhetit në procedurën e propozimit nga kryetari i Komunës për miratim në Kuvend.
- b) Është përgjegjëse për mbajtjen e llogarive dhe raporteve financiare periodike dhe vjetore.
- c) Është përgjegjëse për bashkëpunim me thesarin.
- d) Është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e sistemeve dhe procedurave për ekzekutimin e buxhetit.
- e) Përgatitë procedurat dhe raportet e kontabilitetit.
- f) Ndihmon organet e komunës në planifikimin e mjeteve buxhetore.
- g) Jep këshilla Komitetit për Politikë dhe Financa dhe komiteteve tjera mbi të gjitha çështje që kanë të bëjnë me buxhetin e Komunës.
- h) Planifikon, përcakton obligimet në bazë të rregulloreve komunale të subjekteve të caktuara në Komunë, shkallën e ngarkesës (tarifën) nga lëmi i tatimit në pronë, taksave dhe gjobave komunale.
- i) Mban evidencën e të hyrave buxhetore nga të hyrat vetanake të Komunës.

Neni 70

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim

Në kuadër të kësaj Drejtorie themelohen sektorët me emërtimet në vijim

1. Sektori për Ekonomi dhe Zhvillim

Kjo Drejtori do t'i ushtrroj përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore:

- a) Harton projektin e Planit strategjik zhvillimor të Komunës.
- b) Harton plane për shfrytëzimin e burimeve ekonomike brenda Komunës.
- c) Është përgjegjëse për krijimin e kushteve të qëndrueshme për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
- d) Është përgjegjëse për bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe mundësisë së koordinimit të punëve e të aktiviteteve për zhvillimin ekonomik të Komunës.
- e) Bashkëveprim me ndërkombëtarët për koordinimin e punëve rreth zhvillimit ekonomik të Komunës.
- f) Dhënie e lejes së punës, inkasimi i pagesave të lejeve të punës, evidentimin e ndryshimeve në lejet e punës dhe certifikatave të biznesit, dhënia e formularëve për aplikim paraprak për biznese, dhënia e informatave profesionale dhe raporteve për drejtorinë dhe institucionet e komunës.
- g) Kryen edhe punët tjera nga kompetenca e Komunës në lëmin e ekonomisë dhe të zhvillimit.
- h) Koordinon punët e tjera në bashkëpunim me komunitetet e interesit.”

Neni 71

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

71.1 Në kuadër të kësaj Drejtorie themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

1. Sektori për urbanizëm dhe planifikim
2. Sektori për mbrojtje të mjedisit

71.2 Drejtoria për urbanizëm, shërbime komunale, gjeodezi, kadastrë dhe pronë ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i urbanizmit, shërbimeve komunale, gjeodezisë, kadastrit dhe pronës, si vijon:

- a) Harton planin e zhvillimit hapësinor, urbanistik dhe rural të Komunës,
- b) Bënë përgatitjen dhe hartimin e akteve të përgjithshme normative të planifikimit urban dhe rural,
- c) Bashkëpunon me institucionet e Komunës me rastin e përgatitjes dhe hartimit të planit hapësinor, urbanistik, planeve të rregullimit dhe planeve tjera,
- d) Bënë planifikimin dhe zhvillimin hapësinor të Komunës,
- e) Përcakton kushtet për rregullimin hapësinor,
- f) Mban evidencat për emërtimet e vendbanimeve, rrugëve, shesheve si dhe numrat e objekteve dhe shtëpive.
- g) Bashkëpunon me Kuvendin e Komunës, Komitetin për urbanizëm dhe planifikim urban, kur ato trajtojnë çështjet nga lëmi i planifikimit hapësinor dhe urbanizmit,
- h) Merr pjesë aktive në procedurat e planifikimit të hapësirës dhe rregullimit të tokës ndërtimore, planeve dhe programeve nga kjo lëmi,
- i) Këshillon palët në procedurë dhe mënyrën e realizimit të të drejtave nga lëmi i urbanizmit, kryen dhe detyrat tjera nga fushëveprimi i vet dhe lëmi i rregullimit të hapësirës,
- j) Përpunon kërkesat për lëshimin e lejeve ndërtimore dhe përcakton kushtet urbanistike për zbatimin e planit hapësinor, planin urbanistik, planet e rregullimit, planit të parcelimit, vijës së rregullimit dhe ndërtimit,
- k) Lëshon lejet e ndërtimit, lejet e përdorimit dhe shfrytëzimit, cakton komisione për mbikëqyrjen të objekteve, jep pëlqimet e rregullimit të infrastrukturës,
- l) Menaxhon projektet komunale të paraparë me buxhet nga lëmi i urbanizmit

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë

Neni 72

72.1 Në kuadër të kësaj Drejtorie themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

1. Sektori për Kadastrë dhe
2. Sektori për Gjeodezi

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastrë dhe pronë ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi gjeodezisë, kadastrit dhe pronës, si vijon

- a) Bënë përgatitjen dhe hartimin e rregulloreve, projekteve, vendimeve dhe këshillave profesionale, organeve të Kuvendit të Komunës që kanë të bëjnë me planifikimin urban, kadastrë dhe gjeodezi.
- b) Ndihmon në përgatitjen e lëndëve që i drejtohen, përgatitë lëndët për Gjykatë dhe subjektet tjera të involvuara në zbatimin e Ligjit dhe dispozitave nga lëmi e urbanizmit dhe rindërtimit.
- c) Përgatitë materiale lidhjen e kontratave mbi dhënien me qira të tokës ndërtimore.
- d) Vlerësimin e pronës sipas kriterëve dhe standardeve dhe rregulloreve në fuqi.
- e) Sigurimin e zotërimit të tokës, reduktimin e kontesteve për tokën.
- f) Planifikimin e rrjetit me pikat e reja kontrolluese dhe themelimin e pikave të reja kontrolluese.
- g) Digjitalizimin e pikave poligonale dhe trigonometrike.
- h) Ndarjen e ngastrave dhe shënimin e kufijve me rastin e eksproprijimit dhe kryen procedurat rreth eksproprijimit të tokës.
- i) Inspektimin e sipërfaqes së ndërtesave dhe përpunimin e skicave të ndarjeve për ndërtesa dhe banesa.
- j) Regjistrimin e pronës së paluajtshme dhe regjistrin e tokës komunale.
- k) Shqyrton dhe kryen procedurat administrative për kthimin e tokës pronarëve të mëparshëm.
- l) Mbron pronën komunale nga uzurpimet dhe udhëheq procedurat lidhur me këtë çështje.
- m) Jep shënime mbi madhësinë dhe destinimin e ngastrës së caktuar ndërtimore ose kompleksit të tokës dhe karakteristikat e parashtruara të ndërtimit
- n) Bënë vërtetimin dhe zbaton shitblerjen e pasurisë së patundshme.
- o)

Neni 73

Drejtoria për Shërbime Publike Komunale dhe Emergjencë

73.1 Në kuadër të kësaj Drejtorie themelohen sektorët me emërtime si vijon:

1. Sektori për Shërbime Publike Komunale dhe
2. Sektori për Emergjencë

Drejtoria për Shërbime Publike Komunale dhe emergjencë kryen punët dhe ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i shërbimeve publike komunale dhe emergjencës si vijon:

- a) Menaxhon projektet komunale të parapara me buxhet nga lëmi i infrastrukturës të ujit, kanalizimit dhe hapësirës publike .
- b) Është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve publike komunale, përfshirë: furnizimin me ujë, kanalizim, mirëmbajtjen e rrugëve, transportin lokal, ngrohjen lokale, tregjet, varrezat, hapësirat publike, parqet, mirëmbajtjen e pastërtisë dhe rregullimit të qytetit dhe vendbanimeve tjera, ndërmarrjen e masave për mbrojtjen nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore dhe kryen punët tjera të përcaktuara me ligj.

Drejtoria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural

Neni 74

74.1 Në kuadër të kësaj Drejtorie themelohen sektorët me emërtime në vijim:

1. Sektori për bujqësi dhe pylltari
2. Sektori për zhvillim rural

74.2 Drejtoria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural kryen punët dhe ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, si vijon:

- a) Ndërmerr masa të planifikimit dhe masat tjera që ndikojnë në përparimin e bujqësisë.
- b) Kujdeset të siguroj që tokat bujqësore të shfrytëzohen për prodhimtari bujqësore.
- c) Me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së potencialit bujqësor në mënyrë të përhershme duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomike të Komunës, kujdeset të përcaktohet shfrytëzimi, mbrojtja, rregullimi dhe qiradhënia e tokës bujqësore.
- d) Kujdeset që toka bujqësore e cila është shfrytëzuar për destinime tjera e cila nuk ka karakter të përhershëm t,i kthehet destinimit të parë, të aftësohet për prodhimtari bujqësore sipas projekteve për rikultivim.
- e) Ndërmerr masa të planifikimit dhe masat për ruajtjen e Fondit të pyjeve.
- f) Të koordinoj punën dhe të bashkëveproj me OJQ që përkrahin aktivitetet bujqësore.
- g) Të ofroj trajnime në lëmin e bujqësisë.
- h) Të monitorojë ndihma veterinare dhe të përkujdeset për mbrojtjen e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve të kafshëve shtëpiake.
- i) Mbrojtjen e resurseve natyrore duke përfshirë pyjet, rërën dhe aktivitetet për thyerjen e gurëve nga kompetenca komunale.
- j) Bënë mbrojtjen e resurseve pyjore në territorin e Komunës së Rahovecit dhe kujdeset për rregullimin dhe mbrojtjen e bimëve.
- k) Kryen edhe punët tjera nga kompetenca e Komunës nga lëmi i bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Drejtoria për Punët Inspektuese

Neni 75

75.1 Kjo Drejtori përmes inspektorëve të sajë kryen punët nga përgjegjësia e inspektorit të tregut, punëve sanitare, trafikut, ndërtimtarisë, bujqësisë, veterinarisë, shërbimeve komunale, hidroekonomisë dhe inspektimet tjera të përcaktuara me Ligj.

- a) Në kuadër të Drejtorisë për inspektion e që janë në përgjegjësi të Komunës sipas dispozitave ligjore kryhen punët e inspektimit të tregut, sanitar, trafikut, ndërtimtarisë, bujqësisë, veterines, shërbimet komunale, hidroekonomisë dhe inspektimet tjera komunale të përcaktuara me ligj.
- b) Ndërmerr procedurat ligjore, në kuadër të inspektimit nga sferat e inspektimit komunal në procedurë administrative dhe gjyqësore.
- c) Kryen edhe punët tjera të përcaktuara me Ligjin.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Neni 76

76.1 Në kuadër të kësaj Drejtorie themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

- 1. Sektori për kulturë,
- 2. Sektori për rini dhe sport.

76.2 Drejtoria për kulturë, rini dhe sport ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i rinisë, kulturës dhe sportit:

- a) Planifikon dhe organizon aktivitetet kulturore sportive dhe rinore.
- b) Menaxhon me objektet komunale të kulturës, sportit dhe rinisë.
- c) Organizon tribuna për zhvillimin e kulturës, sportit dhe rinisë.
- d) Mban shënime mbi të arriturat kulturore, sportive dhe rinore.
- e) Të organizoj dhe të shënoj datat me rëndësi historike të Komunës.
- f) Të respektoj, të përkrah dhe të ndihmoj asociacione, klube dhe shoqata në sferën e kulturës, rinisë dhe sportit.
- g) Të josh investitorët dhe të kërkojë fonde shtesë konform Ligjit mbi sportin dhe udhëzimeve administrative.
- h) Të organizoj debate për zhvillim dhe avancim të kulturës, rinisë dhe sportit.
- i) Të krijoj kushte për kthimin e rinisë në vend dhe riedukimin e tyre.
- j) Të organizoj anketa, seminare e trajnime të ndryshme dhe kyçjen e rinisë komunale në aktualitete rinore, evropiane dhe botërore.
- k) Kryen edhe punët tjera të përcaktuara me Ligj dhe me këtë Statut nga kompetenca e Komunës.

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Neni 77

Zyra komunale e komuniteteve në kuadër të dispozitave ligjore bënë përpjekje që në kuadër të Komunës të sigurojë që:

- a) Asnjë person i cili merr detyra publike ose mban poste publik nuk guxoj të bëjë diskriminim ndaj asnjë personi në kurrfarë baze për shkak të gjuhë, përkatësisë etnike ose shoqërimin me komunitete tjera.

- b) Të gjithë persona të gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtat civile, politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe mundësitë të tjera të barabarta në punësim, në shërbime komunale, në të gjitha nivelet.
- c) Që shërbimi komunal civil të pasqyrojë në proporcion të drejtë numrin e përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve në të gjitha nivelet.
- d) Zyra komunale për komunitete udhëhiqet nga udhëheqësi i kësaj zyre i cili rekrutohet konform dispozitave ligjore mbi rekrutimin civil në Kosovë.
- e) Zyra komunale për komunitete mund të themelojë nën zyre, nëse ato nevojiten për ofrimin e shërbimeve publike, të sigurta dhe të lira në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës.

PJESA E TETË SHËRBIMI CIVIL KOMUNAL

Shërbyesi civil

Neni 78

Shërbimi civil komunal përfshin persona të punësuar nga autoriteti komunal, rroga e të cilëve paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës, përveç:

- a) Kryetarit, nënkryetarit/ve dhe drejtorëve komunal.
- b) Kryesuesit dhe të gjithë anëtarëve të Kuvendit të komunës.

Udhëheqja

Neni 79

Shërbimi civil komunal udhëhiqet në bazë të parimeve dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Me rastin e rekrutimit të personelit të Komunës duhet respektuar procedurat e hapura dhe konkurruese për të pranuar shërbyes civil të Komunës me kualitet të lartë, në bazë të meritave dhe kompetencave.

Udhëheqësi i personelit

Neni 80

Administrata komunale ka udhëheqësin e personelit, i cili rekrutohet nga Kryetari i Komunës, në pajtim me rregullat dhe procedurat ligjore të Shërbimit civil në Republikën e Kosovës.

Punësimi

Neni 81

81.1 Punësimi në shërbimin civil komunal duhet të mbikëqyret dhe rregullohet nga udhëheqësi i personelit për të siguruar që shërbimi civil reflekton proporcion të drejtë profesional, gjinor dhe etnik.

81.2 Shërbimi civil komunal si tërësi duhet që të përmbajë proporcion të drejtë të përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuar.

Neni 82

Kryetari i Komunës në bashkëpunim me udhëheqësin e personelit do të emërojë një nën – komision detyrat e të cilit do të jenë këshillimi dhe konsultimi në përgjithësi për çështjet e resurseve njerëzore që kanë të bëjnë me shërbimin civil komunal në veçanti me çështjet në vijim:

- a) Kategoritë dhe numrat për kategori
- b) Mbikëqyrja dhe përgjegjësitë
- c) Detyrat dhe obligimet
- d) Delegimi i detyrave dhe obligimeve
- e) Rekrutimi dhe përzgjedhja
- f) Kushtet e pranimit
- g) Fillimi i punës në zyrë dhe puna provuese
- h) Procedurat ankimore
- i) Procedurat e kundërshtimeve
- j) Trajnimi dhe provimet
- k) Rishqyrtimi i paraqitjes dhe procedurat e vlerësimit
- l) Përparimi dhe suksesi në karrierë
- m) Dosjet dhe referencat e stafit
- n) Kohëzgjatja e punës dhe njoftimi mbi pushimin e marrëdhënies së punës
- o) Pagesat dhe shpërblimet tjera
- p) Pagesat për udhëtim dhe mëditjet
- q) Pushimi
- r) Rregullat e shërbimit civil komunal.

PJESA E NËNTË

KAPITULLI I - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 83

Në rastet kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave statutare me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, vlejnë dispozitat e Ligjit.

Neni 84

Ky Statut hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe nënshkrimit të tij nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Neni 85

Pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti pushojnë të vlejnë të gjitha dispozitat dhe aktet juridike komunale të mëparshme në ato pjesë ku janë në kundërshtim me këtë Statut.

Neni 86

Me aprovimin e këtij Statuti të gjitha aktet tjera të Komunës brenda tre muajve do të harmonizohen me Statutin në fuqi.

Neni 87

Interpretimi autentik i këtij statuti bëhet nga Kuvendi i Komunës.

01 Nr. 569/1
Rahovec, 16.12. 2010

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

KRYESUESI I KUVENDIT

Kujtim Popaj